



# Politika e TAP-it për të Drejtat e Njeriut

Respektimi i të drejtave të njeriut është një pjesë thelbësore e Kodit të Sjelljes së TAP-it “Jetojmë sipas Vlerave Tona” dhe kulturës sonë të korporatës. TAP-i është i bindur që një mjedis pune i karakterizuar nga integriteti, respekti dhe të qenurit mendje hapur është thelbësor për mëkëmbimin e kënaqësisë së punonjësve tanë dhe angazhimit tonë si një ofruer i përgjegjshëm shërbimesh.

Në përputhje me përgjegjësinë e TAP-it për të respektuar të drejtat e të tjerëve, ne i trajtojmë të gjithë në mënyrë të drejtë, me respekt dhe me dinjitet. Ne respektojmë dhe mbështesim mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sferën tonë të ndikimit. Kjo politikë përbën bazën për rrënjëzimin e përgjegjësisë sonë për respektimin e të drejtave të njeriut.

TAP-i zbaton të gjitha ligjet kombëtare që lidhen me punësimin, kodet dhe konventat ndërkombëtare të punës, shëndetit, sigurisë dhe sigurimit dhe është i angazhuar të mbajë lart parimet e përcaktuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara. TAP-i është i angazhuar të zbatojë Parimet Vullnetare për Sigurinë dhe të Drejtat e Njeriut. Ne gjithashtu kërkojmë që kontraktorët tanë të zbatojë Deklaratën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për Parimet dhe të Drejtat Thelbësore në Punë.

Sipas pikëpamjes së TAP, mbrojtja e të drejtave të njeriut kërkon që ne të kuptojmë se si biznesi ynë mund të ndikojë mbi të drejtat e njeriut; të identifikojmë abuzimin e tyre dhe të menaxhojmë në mënyrë proaktive rreziqet si dhe mundësitë për të përmirësuar kushtet e personave që ndikohen nga ne.

Përkushtimi ynë ndaj të drejtave të njeriut shtrihet për të gjithë forcën tonë punëtore dhe mbështetet nga Kodi ynë i Sjelljes. Në TAP ne marrim vendime që promovojnë shanset e barabarta dhe diversitetin.

Ne kemi përgjegjësinë të ndërgjegjësojmë punonjësit tanë mbi çështje të lidhura me të drejtat e njeriut dhe t'i nxisim ata të ruajnë të drejtën e tyre për mbrojtje. Ne do të kërkojmë mënyra për të parandaluar ose lehtësuar ndikimet negative mbi të drejtat e njeriut.

Ian Bradshaw, Drejtor Menaxhues i TAP-it  
Baar, Maj 2016